VENDIM
Nr. 558, datë 27.7.2016

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË NJËSISË ADMINISTRATIVE RUZHDIE, BASHKIA PATOS, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të njësisë administrative përbërëse Ruzhdie, të Bashkisë Patos, që transfe-rohen në pronësi ose në përdorim të saj, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij

Lista e inventarit të njësisë administrative Ruzhdie përbëhet nga 54 (pesëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rendor 865 (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë).

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Bashkisë Patos dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Njësia Admistratrative Ruzhdie Bashkia Patos — Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
14-18, 18/1	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
19-25	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
43-45	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
26,27,27/1,27/2,27/3,27/4, 28,28/1, 29-42,	Varrezat publike	Në pronësi
407-596,733-743,855-865	Infrastrukturë (Sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
46-239, 241-299	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
300-406, 597-646	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi